FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.173 24 dhjetor 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ nr.6, datë 22.12.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar.....	8875
Vendim i KM nr.975, datë 1.12.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.540, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues në nismën për transparencë në industrinë nxjerrëse (EITI)".....	8879
Vendim i KM nr.976, datë 1.12.2010	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).....	8879
Vendim i KM nr.977, datë 1.12.2010	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Meksiko, Shtetet e Bashkuara të Meksikës.....	8879
Vendim i KM nr.978, datë 1.12.2010	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Islamabad, Republika Islamike e Pakistanit.....	8880
Vendim i KM nr.979, datë 1.12.2010	Për hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Pretoria, Afrikë e Jugut.....	8880
Vendim i KM nr.980, datë 1.12.2010	Për shpronësimin shtesë, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier.....	8881
Vendim i KM nr.981, datë 1.12.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga hyrëse, Berat" (shtesat).....	8882
Vendim i KM nr.982, datë 1.12.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit "Rruga transballkanike, Vlorë".....	8883

Vendim i KM nr.983, datë 10.11.2010	Për përcaktimin e kompetencave të Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" dhe riorganizimin e disa institucioneve të trashëgimisë kulturore.....	8884
Vendim i KM nr.984, datë 1.12.2010	Për lejimin e disa institucioneve, në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si autoritete kontraktore, për kryerjen e procedurave të prokurimit.....	8885
Vendim i KM nr.985, datë 1.12.2010	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të katit përdhe të ndërtesës së Spitalit Infektiv, Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për funksionimin e Fakultetit të Infermieristikës, të universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan.....	8886
Vendim i KM nr.986, datë 1.12.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit të kryera nga Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore.....	8888
Vendim i KM nr.987, datë 1.12.2010	Për kontributin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Qeverinë Afgane, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.....	8889
Vendim i KM nr.988, datë 1.12.2010	Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve të Bankës së Shqipërisë....	8889
Vendim i KM nr.989, datë 9.12.2010	Për krijimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit të emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmbytjet natyrore.....	8890
Vendim i KM nr.990, datë 10.12.2010	Për kalim fondi nga Ministria e Drejtësisë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit.....	8890
Vendim i KM nr.991, datë 10.12.2010	Për rishpërndarje fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	8891
Vendim i KM nr.994, datë 6.10.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.438, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo".....	8891
Vendim i KM nr.1015, datë 10.12.2010	Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.....	8892
Udhëzim i MPÇSSHB nr.2209, datë 25.11.2010	Mbi zbatimin e vendimit nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar	8909
Udhëzim i MPÇSSHB nr.2210, datë 25.11.2010	Mbi zbatimin e vendimit nr.618, datë 7.9.2006 "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar.....	8909
Udhëzim i MPÇSSHB nr.2211, datë 25.11.2010	Mbi zbatimin e vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar.....	8910

Vendim i ERRU nr.50, datë 18.11.2010	Për licencim për herë të parë të Ujësjellës sh.a.Orikum.....	8910
Vendim i ERRU nr.51, datë 24.11.2010	Për licencim për herë të parë të Ujësjellës Shërbime Komunale sh.a. Krastë.....	8911
Kërkesë e METE nr.8637/7,datë 25.11.2010	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të palujatshme, të tipit "tokë bujqësore" dhe "kulturave bujqësore" që preken nga "Ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 kV Tirana 2, Kashar, Tiranë".....	8911
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të shtetasit Piro Kodhimaj.....	8913

AKT NORMATIV
Nr.6, datë 22.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10 190, DATË 26.11.2009 "PËR BUXHETIN E VITIT 2010", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës dhe të nenit 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve, për vitin 2010 është:

Të ardhurat gjithsej	1 750 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- të ardhura të tjera	1 400 milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	350 milionë lekë;
Shpenzimet	1 750 milionë lekë.".

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
1. Në paragrafin e parë, shifrat ndryshojnë, si më poshtë vijon:
"Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzime korente	221 839 milionë lekë;
Shpenzimet kapitale	71 045 milionë lekë;
Fondi rezervë	2 500 milionë lekë;
Fondi i kontigjencës	2 730 milionë lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensioneve	4 278 milionë lekë."

2. Tabela 1, që përmendet në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.
3. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Gjendja e mjeteve monetare, që do të rezultojë në fund të vitit buxhetor në llogarinë unike të thesarit, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve ose tejkalimit të të ardhurave, të transferohet në llogarinë e shpronësimeve për interesa publikë.".

Neni 3

Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tab.1

BUXHETI I RISHIKUAR I VITIT 2010 SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
1	**Presidenca**	**141,480**	**59,500**	**0**	**0**	**59,500**	**200,980**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	57,470	59,500	0	0	59,500	116,970
01120	Veprimtaria e Presidentit	84,010	0	0	0	0	84,010
2	**Kuvendi**	**716,700**	**121,000**	**0**	**0**	**121,000**	**837,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	716,700	121,000	0	0	121,000	837,700
3	**Keshilli Ministrave**	**277,108**	**42,500**	**0**	**0**	**42,500**	**319,608**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	277,108	42,500	0	0	42,500	319,608
4	**Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes**	**1,006,960**	**308,200**	**0**	**1,540,905**	**1,849,105**	**2,856,065**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	287,960	35,000	0	0	35,000	322,960
04320	Mbeshtetje per Energjine	1,000	45,000	0	373,000	418,000	419,000
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	184,000	160,000	0	0	160,000	344,000
04440	Mbesht. Miniera e Nd/je Publike	0	0	0	400,000	400,000	400,000
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	253,600	37,200	0	462,905	500,105	753,705
04160	Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	280,400	31,000	0	80,000	111,000	391,400
04770	Mbeshtetje per Zhvillim Rajonal	0	0	0	225,000	225,000	225,000
5	**Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit**	**3,656,920**	**928,170**	**0**	**470,256**	**1,398,426**	**5,055,346**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	213,000	52,000	0	0	52,000	265,000
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,228,286	147,500	0	50,256	197,756	1,426,042
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	777,915	467,390	0	180,000	647,390	1,425,305
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.	1,212,619	230,757	0	240,000	470,757	1,683,376
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	216,600	30,523	0	0	30,523	247,123
05470	Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore	8,500	0	0	0	0	8,500
6	**Ministria e Puneve Publike dhe Transportit**	**4,096,394**	**32,386,205**	**0**	**11,454,846**	**43,841,051**	**47,937,445**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	308,695	2,800	0	0	2,800	311,495
04520	Rrjeti i rrugeve nacionale	1,355,178	26,889,505		6,956,000	33,845,505	35,200,683
04530	Menaxhimi i Transportit	24,301	0	0	0	0	24,301
04540	Portet	66,995	302,000	0	630,000	932,000	998,995
04550	Hekurudhat	452,926	50,000	0	0	50,000	502,926
04560	Aviacioni Civil	54,630	26,000	0	0	26,000	80,630
06370	Ujesjelles Kanalizime	862,832	4,512,500	0	3,228,846	7,741,346	8,604,178
06180	Strehimi dhe Urbanistika	807,527	367,400	0	640,000	1,007,400	1,814,927
06220	Sherbimet publike	163,310	236,000	0	0	236,000	399,310
10	**Ministria e Financave**	**5,806,296**	**329,489**	**0**	**160,000**	**489,489**	**6,295,785**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	190,178	36,440	0	0	36,440	226,618
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	483,169	3,900	0	0	3,900	487,069
01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	111,000	0	0	0	0	111,000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	1,951,058	105,000	0	0	105,000	2,056,058
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	1,348,597	129,600	0	160,000	289,600	1,638,197
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	44,100	4,550	0	0	4,550	48,650
10270	Menaxhimi i Sigurimeve Shoqerore	1,615,000	49,999	0	0	49,999	1,664,999
01180	Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike	63,192	0	0	0	0	63,192
11	**Ministria e Arsimit dhe Shkences**	**32,928,436**	**3,585,310**	**0**	**956,224**	**4,541,534**	**37,469,970**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	872,807	24,034	0	10,000	34,034	906,841
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	20,332,268	2,277,813	0	250,000	2,527,813	22,860,081
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	4,197,216	565,796	0	204,400	770,196	4,967,412
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	1,887,784	90,968	0	276,224	367,192	2,254,976
09450	Arsimi Universitar	5,410,361	626,699	0	215,600	842,299	6,252,660
09770	Fonde per Shkencen	228,000	0	0	0	0	228,000
12	**Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve**	**1,537,980**	**172,000**	**0**	**373,851**	**545,851**	**2,083,831**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	132,874	950	0	0	950	133,824
08220	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	342,454	59,473	0	168,193	227,666	570,120
08230	Arti dhe Kultura	657,774	109,769	0	0	109,769	767,543
08140	Zhvillimi i Sportit	179,964	480	0	0	480	180,444
08170	Programe per Rinine	52,480	0	0	0	0	52,480
04760	Zhvillimi i Turizmit	90,654	1,328	0	205,658	206,986	297,640
08480	Mbeshtetje per Kultet Fetare	81,780	0	0	0	0	81,780
13	**Ministria e Shendetesise**	**23,646,480**	**1,546,217**	**35,000**	**645,138**	**2,226,355**	**25,872,835**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	198,100	43,968	0	0	43,968	242,068
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	7,001,600	268,867	10,000	359,500	638,367	7,639,967
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	13,798,280	1,219,332	20,000	285,638	1,524,970	15,323,250
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	2,648,500	14,050	5,000	0	19,050	2,667,550

Tab.1

BUXHETI I RISHIKUAR I VITIT 2010 SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
14	**Ministria e Drejtesise**	**5,015,720**	**357,030**	**0**	**510,000**	**867,030**	**5,882,750**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	243,579	23,130	0	0	23,130	266,709
01120	Publikimet Zyrtare	47,590	0	0	0	0	47,590
01130	Mjekesia Ligjore	39,070	4,000	0	0	4,000	43,070
03440	Sistemi i Burgjeve	3,408,604	296,870	0	450,000	746,870	4,155,474
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor	158,960	0	0	0	0	158,960
01160	Sherbimet per çeshtjet e biresimeve	13,020	300	0	0	300	13,320
01170	Sherbimi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme	546,100	18,600	0	60,000	78,600	624,700
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	507,720	5,000	0	0	5,000	512,720
03490	Sherbimi i Proves	51,077	9,130	0	0	9,130	60,207
15	**Ministria e Puneve te Jashtme**	**1,932,320**	**77,000**	**0**	**0**	**77,000**	**2,009,320**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	55,962	4,000	0	0	4,000	59,962
01120	Perfaqesite Diplomatike	1,629,088	70,000	0	0	70,000	1,699,088
01130	Promovimi i imazhit te vlerave te vendit	120,430	1,000	0	0	1,000	121,430
01140	Integrimi europian dhe euro-atlantik	126,840	2,000	0	0	2,000	128,840
16	**Ministria e Brendshme**	**15,408,041**	**828,297**	**32,103**	**724,888**	**1,585,288**	**16,993,329**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	662,480	11,297	0	10,658	21,955	684,435
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	75,580	1,115	0	0	1,115	76,695
03140	Policia e Shtetit	10,321,640	763,129	32,103	714,230	1,509,462	11,831,102
03150	Garda e Republikes	1,194,000	1,409	0	0	1,409	1,195,409
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te P. Vendor	614,600	0	0	0	0	614,600
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	696,030	48,994	0	0	48,994	745,024
01180	Menaxhimi i Rezervave te Shtetit	176,010	2,353	0	0	2,353	178,363
10910	Emergjencat Civile	1,667,700	0	0	0	0	1,667,700
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**16,158,090**	**3,484,972**	**100,000**	**6,286**	**3,591,258**	**19,749,348**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,131,479	45,000	0	0	45,000	1,176,479
02120	Forcat e Luftimit	5,473,173	2,798,722	0	0	2,798,722	8,271,895
09430	Arsimi Ushtarak	1,089,802	116,150	0	0	116,150	1,205,952
07340	Mbeshtetje Shendetesore	574,742	20,000	0	6,286	26,286	601,028
02150	Mbeshtetja e Luftimit	3,791,831	248,400	100,000	0	348,400	4,140,231
02160	Mbeshtetja e Perqendruar	384,261	239,600	0	0	239,600	623,861
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	2,920,000	0	0	0	0	2,920,000
02280	Bashkepunimi Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC)	792,802	17,100	0	0	17,100	809,902
18	**Sherbimi Informativ Shteteror**	**1,147,323**	**98,000**	**0**	**0**	**98,000**	**1,245,323**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	364,439	98,000	0	0	98,000	462,439
03520	Veprimtaria Informative Shteterore	782,884	0	0	0	0	782,884
19	**Drejtoria e Radio Televizionit**	**364,260**	**65,000**	**0**	**0**	**65,000**	**429,260**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	0	0	0	0	0
08320	Veprimtaria Radiotelevizive e RTSH-se	364,260	65,000	0	0	65,000	429,260
20	**Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave**	**164,660**	**13,000**	**0**	**0**	**13,000**	**177,660**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	164,660	13,000	0	0	13,000	177,660
22	**Akademia e Shkences**	**81,790**	**1,000**	**0**	**0**	**1,000**	**82,790**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	8,896	1,000	0	0	1,000	9,896
01520	Veprimtaria Akademike	72,894	0	0	0	0	72,894
24	**Kontrolli Larte i Shtetit**	**265,740**	**7,500**	**0**	**0**	**7,500**	**273,240**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	42,474	7,500	0	0	7,500	49,974
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	223,266	0	0	0	0	223,266
25	**Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta**	**49,515,770**	**110,950**	**5,000**	**0**	**115,950**	**49,631,720**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	137,810	20,000	0	0	20,000	157,810
10220	Sigurimi Shoqeror	28,407,824	0	0	0	0	28,407,824
10430	Mbrojtja Sociale	19,268,476	5,000	0	0	5,000	19,273,476
10550	Tregu i Punes	1,533,460	65,750	5,000	0	70,750	1,604,210
04170	Inspektimi ne Pune	150,660	18,500	0	0	18,500	169,160
10460	Shanset e Barabarta	17,540	1,700	0	0	1,700	19,240
26	**Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave**	**1,116,700**	**163,400**	**26,600**	**444,720**	**634,720**	**1,751,420**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	74,000	10,000	0	0	10,000	84,000
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	107,000	28,019	0	291,720	319,739	426,739
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	70,000	23,150	0	30,000	53,150	123,150
05640	Administrimi i Ujrave	30,600	0	0	0	0	30,600
04260	Administrimi i Pyjeve	835,100	102,231	26,600	123,000	251,831	1,086,931
28	**Prokuroria e Pergjithshme**	**1,121,960**	**113,855**	**0**	**0**	**113,855**	**1,235,815**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,121,960	113,855	0	0	113,855	1,235,815

Tab.1

BUXHETI I RISHIKUAR I VITIT 2010 SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale				Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
29	**Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor**	**1,479,880**	**180,000**	**0**	**0**	**180,000**	**1,659,880**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	27,900	500	0	0	500	28,400
03310	Buxheti Gjyqesor	1,451,980	179,500	0	0	179,500	1,631,480
30	**Gjykata Kushtetuese**	**94,280**	**5,000**	**0**	**0**	**5,000**	**99,280**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	38,650	5,000	0	0	5,000	43,650
03320	Veprimtaria Gjyqesore Kushtetuese	55,630	0	0	0	0	55,630
31	**Agjensia Telegrafike Shqiptare**	**88,380**	**5,000**	**0**	**0**	**5,000**	**93,380**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,878	5,000	0	0	5,000	35,878
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	57,502	0	0	0	0	57,502
40	**Partite Politike**	**212,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**212,000**
01110	Mbeshtetje per Partite Politike	199,000	0	0	0	0	199,000
01120	Mbeshtetje per Shoqatat	10,000	0	0	0	0	10,000
01130	Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status	3,000	0	0	0	0	3,000
50	**Instituti Statistikes**	**367,300**	**10,000**	**0**	**10,000**	**20,000**	**387,300**
01310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	164,053	10,000	0	10,000	20,000	184,053
01320	Veprimtaria Statistikore	203,247	0	0	0	0	203,247
55	**Shkolla e Magjistratures**	**50,700**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**52,700**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	18,610	1,000	0	0	1,000	19,610
09820	Veprimtaria Arsimore	32,090	1,000	0	0	1,000	33,090
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**1,059,000**	**0**	**3,597,000**	**4,656,000**	**4,656,000**
06210	Programe Zhvillimi	0	1,059,000	0	3,597,000	4,656,000	4,656,000
57	**Qendra Kombetare e Kinematografise**	**114,164**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**116,164**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	27,670	2,000	0	0	2,000	29,670
08220	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	86,494	0	0	0	0	86,494
59	**Instituti i Integrimit te Perndjekurve Politik**	**26,460**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**28,460**
01110	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	26,460	2,000	0	0	2,000	28,460
63	**Keshilli i Larte i Drejtesise**	**74,280**	**4,000**	**0**	**0**	**4,000**	**78,280**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	39,348	4,000	0	0	4,000	43,348
03320	Veprimtaria mbikqyrese e KLD	34,932	0	0	0	0	34,932
66	**Avokati i Popullit**	**80,440**	**6,000**	**0**	**0**	**6,000**	**86,440**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	20,460	6,000	0	0	6,000	26,460
03320	Sherbimi i avokatise	59,980	0	0	0	0	59,980
67	**Komisioni i Sherbimit Civil**	**41,580**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**43,580**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	41,580	2,000	0	0	2,000	43,580
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**94,560**	**3,000**	**0**	**0**	**3,000**	**97,560**
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	94,560	3,000	0	0	3,000	97,560
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0	0
76	**Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive**	**81,980**	**4,000**	**0**	**0**	**4,000**	**85,980**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	81,980	4,000	0	0	4,000	85,980
77	**Autoriteti i Konkurences**	**57,360**	**5,000**	**0**	**0**	**5,000**	**62,360**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	11,081	500	0	0	500	11,581
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurences	46,279	4,500	0	0	4,500	50,779
78	**Ministria e Integrimit**	**160,560**	**9,200**	**0**	**97,000**	**106,200**	**266,760**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	39,580	6,600	0	0	6,600	46,180
01140	Drejtesia dhe Tregu i Brendshem	27,632	1,300	0	29,000	30,300	57,932
01150	Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimit	93,348	1,300	0	68,000	69,300	162,648
82	**Keshilli Kombetar i Kontabilitetit**	**13,160**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**15,160**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	13,160	2,000	0	0	2,000	15,160
86	**Avokati i Prokurimeve**	**23,680**	**2,000**	**0**	**0**	**2,000**	**25,680**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	23,680	2,000	0	0	2,000	25,680
87	**Institucione te tjera Qeveritare**	**352,660**	**566,948**	**0**	**180,000**	**746,948**	**1,099,608**
01320	Sherbime Qeveritare	80,000	116,273	0	0	116,273	196,273
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	56,400	35,675	0	0	35,675	92,075
01140	Sherbime per shoqerite e informacionit	152,860	413,500	0	180,000	593,500	746,360
01150	Sherbime te tjera	63,400	1,500	0	0	1,500	64,900
88	**Mbeshtetje per Shoqerine Civile**	**78,000**	**450**	**0**	**0**	**450**	**78,450**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	78,000	450	0	0	450	78,450
89	**Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale**	**41,140**	**7,000**	**0**	**0**	**7,000**	**48,140**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	41,140	7,000	0	0	7,000	48,140
91	**Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**7,500**	**0**	**0**	**0**	**0**	**7,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	7,500	0	0	0	0	7,500
	TOTALI	**169,647,192**	**46,675,193**	**198,703**	**21,171,114**	**68,045,010**	**237,692,202**

VENDIM
Nr.975, datë 1.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.540, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SEKRETARIATIT PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË, SI VEND ZBATUES NË NISMËN PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRINË NXJERRËSE (EITI)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 190, datë 27.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 7 të vendimit nr.540, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, fjalët "…institucion buxhetor…" zëvendësohen me "… ent publik….".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.976, datë 1.12.2010

PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR EDUKIMIN, SHKENCËN DHE KULTURËN (UNESCO)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).
2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.977, datë 1.12.2010

PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MEKSIKO, SHTETET E BASHKUARA TË MEKSIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Meksiko, Shtetet e Bashkuara të Meksikës.

2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin 2011.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.978, datë 1.12.2010

PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ISLAMABAD, REPUBLIKA ISLAMIKE E PAKISTANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Islamabad, Republika Islamike e Pakistanit.

2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin 2011.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.979, datë 1.12.2010

PËR HAPJEN E PËRFAQËSISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PRETORIA, AFRIKË E JUGUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në Pretoria, Afrikë e Jugut.

2. Shpenzimet për hapjen e kësaj përfaqësie do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, për vitin 2011.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.980, datë 1.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN SHTESË, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LUSHNJË-FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin shtesë për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 725 (një mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) m^2, tokë arë, me vlerë 2 070 000 (dy milionë e shtatëdhjetë mijë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 2 070 000 (dy milionë e shtatëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.12.2010 dhe të përfundojë më 15.3.2011.

7. Pronari i përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarit, për të cilin është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Kalimi i pronësisë në favor të shtetit të bëhet jo vetëm për pasurinë e pasqyruar në listën bashkëlidhur këtij vendimi, por edhe për pasuritë e shpronësuara me të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë miratuar shpronësimet, përgjatë segmentit rrugor Lushnjë-Fier, për të cilat do të bashkëpunohet me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier dhe Lushnjë.

11. Zyra e Qendrore Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier dhe Lushnjë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier dhe Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARIT QË SHPRONËSOHET NË SEGMENTIN RRUGOR LUSHNJË-FIER

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas.	Tokë arë			Shënime
						Sip. m^2	Çmimi Lekë/m^2	Vlera lekë	
1	Luis	Dervish	Veliu	2636	72/36	1725	1200	2 070 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		Totali				**1725**		**2 070 000**	

VENDIM
Nr.981, datë 1.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA HYRËSE, BERAT" (SHTESAT)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga hyrëse, Berat" (shtesat).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) m^2, tokë truall, të vlerësuar me çmimin prej 3 100 (tre mijë e njëqind) lekë/m^2, me vlerë të përgjithshme 864 900 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 864 900 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 263 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.1.2011 dhe të përfundojë më 1.4.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra e Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Berat, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

8882

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE, TË CILËT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE BERAT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas.	Lloji i Pas.	Sip. Shpron. (m^2)	Çmimi Lekë/m^2	Shuma lekë	Shuma Totale lekë	Shënime
1	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/170	Truall	30	3100	93 000	93 000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Nexhmedin	Sulejman	Malasi	8501	2/12	Truall	170	3100	527 000	527 000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Çelnik	Hetem	Shuli	8501	2/172	Truall	79	3100	244 900	244 900	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Shuma						**279**		**864 900**	**864 900**	

VENDIM
Nr.982, datë 1.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT "RRUGA TRANSBALLKANIKE, VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit "Rruga transballkanike, Vlorë".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2 818 (dy mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) m^2, tokë truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 33 816 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 242 000 (dyqind e dyzet e dy mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 33 816 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.12.2010 dhe të përfundojë më 15.4.2011.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria

e Përgjithshme e Rrugëve, për të gjithë segmentin "Rruga transballkanike, Vlorë" dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara me këtë vendim, si dhe vendimet nr.857, datë 29.11.2007, nr.1194, datë 3.12.2010 e nr.62, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin që të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE, PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA RRUGA "TRANSBALLKANIKE", VLORË

Lloji i pasurisë së patundshme: truall

Nr.	Pronari	Nr.Pas.	Z.K.	Truall			Shënime
				Sip. (m^2)	Çmimi lekë m^2	Vlefta në lekë	
1	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/114	8605	428	12000	5 136 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/119	8605	837	12000	1 004 4000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/5	8605	174	12000	2 088 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/62	8605	246	12000	2 952 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/40	8605	889	12000	10 668 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/10	8605	135	12000	1 620 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/11	8605	109	12000	1 308 000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
	Totali			**2 818**		**33 816 000**	

VENDIM
Nr.983, datë 10.11.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS "GANI STRAZIMIRI" DHE RIORGANIZIMIN E DISA INSTITUCIONEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri", më poshtë i quajtur IMK, është institucion qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. IMK-ja ka për objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin dhe propagandimin e trashëgimisë kulturore materiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

3. IMK-ja për realizimin e objektivave të veprimtarisë, sipas pikës 2 të këtij vendimi, ka këto detyra:

a) Harton programet dhe projektet në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel kombëtar dhe vendor.

b) Propozon ndryshime në legjislacionin për trashëgiminë kulturore me pororsi dhe në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

c) Ndjek zbatimin e standardeve e të kritereve për gjurmimin, mbrojtjen, evidentimin, studimin, konservimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës dhe të veprave të artit.

ç) Propozon politika nxitëse dhe mbështetëse për zhvillimin e trashëgimisë kulturore e të investimeve private në këtë fushë.

d) Bashkërendon punën në fushën e trashëgimisë kulturore, ndërmjet institucioneve të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe sektorit privat.

dh) Kryen dhe mbikëqyr ndërhyrjet restauruese.

e) Ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e kritereve të organizimit muzeor të ikonave dhe të atyre arkeologjike.

ë) Ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e kritereve të administrimit të fondeve të luajtshme dhe të paluajtshme të monumenteve të kulturës.

f) Kryen inventarizimin, ruajtjen, propagandimin dhe studimin e pasurive kombëtare në fushën e monumenteve të kulturës.

g) Harton dhe zbaton programet e kualifikimit të specialistëve të fushës së monumenteve të kulturës.

gj) Drejton, në bashkëpunim me UNESCO-n, shkollën e Restaurimeve të Monumenteve të Kulturës.

4. IMK-ja përfaqësohet në qarqe nga drejtoritë rajonale të kulturës kombëtare (DRKK), me përjashtim të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Sarandë. Të gjitha këto institucione organizohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. IMK-ja, nëpërmjet DRKK-ve, kontrollon punimet e drejtpërdrejta restauruese, realizon kontrollin e ruajtjen e monumenteve, konservimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve restauruese nga të tretët, drejtimin e qendrave historike dhe të parqeve arkeologjike, si dhe funksionimin e muzeve tipologjike.

5. Drejtori i IMK-së, drejtorët e DRKK-ve, të parqeve arkeologjike në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

6. IMK-ja përcakton kriteret e veçanta për punonjësit që angazhohen në veprimtaritë me trashëgiminë kulturore. Marrëdhëniet e punës rregullohen në bazë të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Të drejtat dhe detyrat e stafit drejtues dhe të punonjësve që varen prej tyre përcaktohen në rregulloret e brendshme të IMK-së.

7. Personeli teknik i DRKK-ve dhe i organizmave të tyre është pjesë e drejtorisë përkatëse në IMK.

8. Çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

9. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.984, datë 1.12.2010

PËR LEJIMIN E DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, SI AUTORITETE KONTRAKTORE, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e disa institucioneve në varësi të ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si autoritete kontraktore, të vazhdojnë procedurat e prokurimit, brenda vitit 2010, si më poshtë vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktor, për këto objekte:

- Ndërtim rruga "Unaza e Re e Tiranës-Mullet, loti 1",
- Ndërtim rruga e Arbërit (segmenti Dalje U.Vashës-Bulqizë), loti 3;
- Ndërtim rruga "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 4";
- Ndërtim rruga "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë, loti 8";
- Studim – projektim rruga "Tiranë-Dajt-Qafëmollë";
- Studim – projektim, zgjerim i rrugës "Sukth-Hamallaj";
- Studim–projektim–ndërtim, rrugët paralele, segmenti "By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë";
- Studim – projektim – ndërtim, rruga "Tiranë-Elbasan" (dublimi dhe plotësimi i segmentit Ibë-Elbasan).

b) Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Mallakastër, si autoritet kontraktor, për objektin "Ndërtimi i stacionit të pompimit në Qafën e Kashit";

c) Porti Detar, Shëngjin, si autoritet kontraktor, për objektin "Survejimi topografik dhe batimetrik, analizimi i gjendjes së dherave dhe integrimi i vlerësimit mjedisor, për rehabilitimin e Portit Detar, Shëngjin dhe thellimi i kanalit hyrës të portit".

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Mallakastër, Porti Detar, Shëngjin dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.985, datë 1.12.2010

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË KATIT PËRDHE TË NDËRTESËS SË SPITALIT INFEKTIV, ELBASAN, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR FUNKSIONIMIN E FAKULTETIT TË INFERMIERISTIKËS, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të katit përdhe të ndërtesës së Spitalit Infektiv, Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për funksionimin e Fakultetit të Infermieristikës të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet të ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve pronën e përcaktuar në këtë vendim.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE (SPIT INFERMIU)
RIKONSTRUKSION
SHKALLA 1:200



8887

VENDIM
Nr.986, datë 1.12.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të botimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 31.12.2010, për procedurat e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2010, sipas listave nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi, për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore.
2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA NR.1

PROKURIME TË MIRATUARA ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.782, DATË 29.9.2010, PËR TË CILAT NUK KA PËRFUNDUAR PROCEDURA E PROKURIMIT

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi limit me TVSH (lekë)
1	Rikonstruksion QKU, ESKU, Tiranë reparti ushtarak nr.4400	31 000 000
2	Ndërtim rrjeti elektrik në repartin ushtarak nr.1320 Tiranë	9 700 000
3	Blerje aksesorë shtesë të komandimit në distancë (për misionin Afganistan)	9 062 515
4	Blerje karburanti JET-A1	53 881 776
5	Blerje protoxid azoti	565 900
6	Blerje kite laboratori	3 691 990
7	Blerje medikamentesh mjekësore	24 011 520
8	Blerje dezinfektantësh	2 000 000
9	Blerje materiale mjekimi	10 022 560
10	Materiale për funk. e pajisjeve speciale	3 181 140
11	Materiale, shërbime speciale, mrëmbajtje, scaner etj.	3 019 990

LISTA NR.2

(PROKURIMET E PAMIRATUARA ME VENDIM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.782, DATË 29.9.2010)

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi limit me TVSH (lekë)
1	Blerje dekoratash të ndryshme	10 510 000
2	Blerje dhe montim çelësash elektrikë	2 200 000
3	Shërbim transporti për materiale logjistike	2 700 000
4	Blerje uniformash	50 000 000

VENDIM
Nr.987, datë 1.12.2010

PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR QEVERINË AFGANE, NË KUADËR TË PËRPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.200 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien, pa shpërblim, të 30 000 (tridhjetë mijë) automatikëve 7.62 mm, model 56, dhe të 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) fishekëve 7.62 mm, model 56, Qeverisë Afgane, për Policinë Kombëtare Afgane, si kontribut i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.
2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

